



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:052957
Datë: 23.08.2024
Numri i dokumentit: 06081709

C.nr.865/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shaban Shala, me praktikanten gjyqësore E.D. në kontestin e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit F. (M) M. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 175.09 € me datën 15.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Lëshohet urdhërpagesa për paditësin Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, SH.A, me seli në Prishtinë, dhe **detyrohet i padituri F. (M) M.** nga Prizreni, që në emër të kompensimit të dëmit material, t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 175.09 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e marrjes së këtij aktvendimi (15.08.2024) e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e dhënies së urdhërpagesës, të gjitha këto në afatin prej 7 ditëve, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, SH.A, me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurit F. (M) M. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 175.09 €.

Paditësi padisë ia ka bashkangjitur aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren me numër P.nr.1685/17 të datës 18.12.2023, procesverbalin nr. 2416782 të datës 11.05.2017, faturën me nr. DPZHP1711905 të datës 15.05.2027, faturën e kalkulimit të rikthimit të humbjeve me nr. 118576 të datës 15.05.2017 dhe foto dokumentacionin prej 3 fotove.

Duke marrë parasysh aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren me numër P.nr.1685/17 të datës 18.12.2023, procesverbalin nr. 2416782 të datës 11.05.2017, faturën me nr. DPZHP1711905 të datës 15.05.2027, faturën e kalkulimit të rikthimit të humbjeve me nr. 118576 të datës 15.05.2017 dhe foto dokumentacionin prej 3 fotove, konstatohet se i padituri

Numri i lëndës: 2024:052957

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06081709

ka detyrim ndaj paditësit që të paguaj shumën prej 175.09 € në emër të shkaktimit të dëmit, për çka edhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për lëshimin e urdhërpagesës.

Nga sa u tha më lartë, e duke u bazuar në nenin 493, 494 dhe 495, e në lidhje me nenin 497.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
- Departamenti i Përgjithshëm-
C.nr.865/24 të datës 15.08.2024

Praktikantja
Erëza Danjoli

Gjyqtari
Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: kundër urdhërpagesës i padituri mund të parashtrojë vetëm prapësimin dhe atë brenda afatit 7 ditor pas ditës së pranimin të së njëjtës. Prapësimi i paraqitur me vonesë do të hidhet poshtë.